



Thirrje për trajner/e

Kërkojmë trajner/e për mbajtjen e trajnimeve profesionale për ofruesit e shërbimeve (stafi i institucioneve shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, OJQ-të e licencuara, vullnetarët që ofrojnë shërbime për të moshuarit) në temën “Dhuna në Baza Gjinore dhe Parandalimi i Stereotipive për Moshën – Ageism”

Termet e Referencës

Hyrje

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepra lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikën më të mira.

II. Informata të përgjithshme


Syri i Vizionit në bashkëpunim me organizatën Volkshilfe Solidarität janë duke zbatuar programin “**Ndërtimi i komuniteteve miqësore për të moshuarit nëpërmjet veprimit ndër breza në Kosovë - AGE+**” i cili financohet nga Agjensioni Austriak për Zhvillim i cili ka për qëllim që të kontribuojë në forcimin e pjesëmarrjes së të moshuarve në dialog me qeveritë e tyre në nivel lokal, duke shprehur nevojat dhe përfshirjen në vendimmarrje për shërbimet ndaj të tyre, rritjen e kapaciteteve të komunave, sektorëve private dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për të ofruar shërbime për të moshuarit bazuar në rekomandimet e qytetarëve të moshuar dhe rritjen e ofrimit të shërbimeve plotësuese si mbështetje për të moshuarit në nivel lokal.

Ne kuadër të këtij programi SiV do ofroj një trajnim profesional për ngritjen e kapaciteteve institucioneve, OJQ-ve dhe vullnetareve të cilët ofrojnë shërbime për moshën e tretë, që ndërliken në punën e tyre të përditshme në parandalimin e dhunës në baza gjinore, dhe parandalimin e stereotipive kundër moshës.

Trajnimi “Parandalimi i Dhunës në Baza Gjinore” duhet ti referohet modulit të akredituar nga ministria e Shëndetësisë “Puna me viktimat të dhunës në familje – trajtimi dhe referimi” dhe të përshtatet për grup moshën e tretë, si dhe pas trajnimit ofruesit lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore të pajisjen me një manual i cili do i shërbejë në një periudhë me afatgjatë.

AGE+ IMPLEMENTED BY:

volkshilfe.
SOLIDARITÄT



NSHC
NOVOGADSKI HUMANITARNI CENTAR



With funding from

Austrian
Development
Cooperation

III. Objektiva

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një trajner/e-profesionist/e me përvojë (së paku pesëvjeçare) në ngritjen e kapaciteteve në fushën e dhunës në baza gjinore dhe thurjes se stereotipeve për moshën e tretë”

1. “Dhuna në Baza Gjinore”
2. “Parandalimi i Stereotipive për Moshën e tretë– Ageism”

Trajnimet kanë për qëllim të ngritin kapacitetet për ofruesit lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore të cilët punojnë drejtpërdrejt me grup moshën e tretë

Përfitues të trajnimeve do të jenë ofrues të shërbimeve sociale dhe shëndetësore nga komuna e Pejës, e që përfshinë qendrat e mirëqenies sociale, qendrat e mjekësisë familjare, OJQ të licencuara në ofrim të shërbimeve dhe vullnetar që ofrojnë shërbime për të moshuar.

IV. Kualifikimi i nevojshëm:

- Diplomë universitare (kualifikimi Master dhe edukimi profesional/joformal në fushat e kërkuara në kuadër të kësaj thirrje konsiderohen përparësi);
- Dokumentimi i përvojës së trajnimeve/punës në fushat specifike sipas ToR (Dhuna në Baza Gjinore” dhe “Parandalimi i Stereotipive për Moshën e tretë– Ageism”
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, udhëheqëse dhe shkathtësi në shkrim dhe komunikim;
- Shkathtësi të mira në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe.

V. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Nga trajneri/ja i/e angazhuar pritët të:

- Zhvilloj materialet e trajnimit në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it dhe për rishikim dhe miratim paraprak;
- Përgatisë materialet e nevojshme shtesë për trajnim (*rendin e ditës për trajnim si dhe pyetësorët para dhe pas trajnimit*) në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it
- Udhëheqë trajnimin me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse
- Dorëzojë draft raportin narrativ të angazhimit, përfshirë objektivat, realizimin e trajnimeve, dhe të dalurat nga pyetësorët, jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas mbajtjes së trajnimeve;

AGE+ IMPLEMENTED BY:

With funding from

VI. Angazhimi i Ekspertit/es:

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit- nën koordinimin e Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit mars dhe prill në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme. Eksperti/ja, mund të aplikojë për dy temat e trajnimit ose vetëm për një temë:

Detyrat - "Dhuna në Baza Gjimore"	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë së punës për trajnime (materialet në Power Point, rendin e ditës, pyetësorët para dhe pas secilit trajnim dhe materialet tjera shtesë të nevojshme) – duke u bazuar në modulën e akredituar "Puna me viktimat të dhunës në familje – trajtimi dhe referimi"	1 ditë
Mbajtja e trajnimeve	1 ditë
Përgatitja e dokumenteve udhëzuese manualit të trajnimit dhe raportit narrativ	4 ditë
Gjithsej:	6 ditë

Detyrat - "Parandalimi i Stereotipive për Moshën e tretë– Ageism"	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë së punës për trajnime (materialet në Power Point, rendin e ditës, pyetësorët para dhe pas secilit trajnim dhe materialet tjera shtesë të nevojshme)	1 ditë
Mbajtja e trajnimeve	1 ditë
Raporti narrativ	1 ditë
Gjithsej:	3 ditë

VII. Kushtet e Pagesës:

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas kontratës përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të të gjitha trajnimeve dhe dorëzimit të dokumenteve të përcaktuara me ToR.

Në bazë të ligjit të Kosovës, Syri i Vizionit është po ashtu i obliguar që të paguajë tatimin (taksa dhe Pension) prej 10% të shumës bruto. Shpenzimet e ushqimit gjatë trajnimeve dhe transportit në lokacionin e trajnimit do t'i mbulojë organizatori.

AGE+ IMPLEMENTED BY:

volkshilfe.
SOLIDARITÄT



NSHC
NACIONALNI SOCIJALNO HUMANITARNI CENTAR



With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



AGE+ Building Age-Friendly
Communities through
Intergenerational Action in Serbia and Kosovo



VIII. Dokumentet e kërkuara dhe procedura për aplikim:

1. Kopja e diplomës universitare (ndonjë certifikatë e licencimit nga institucioni përgjegjës konsiderohet përparësi);
2. Përshkrimi i metodologjisë së punës, duke përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të materialeve për trajnim dhe mbajtjen e trajnimeve;
3. Biografia - CV
4. Propozimi financiar*

**Oferta financiare duhet të jetë e hollësishme për secilën punë që do të realizohet, duke përfshirë, zhvillimin e modulit dhe materialet e trajnimit, mbajtjen e trajnimeve dhe shkrimin e raportit.*


Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: office@syriivizionit.org ose dukagjin.nishiqi@syriivizionit.org me subjektin: Aplikacioni për trajnim.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 03 tetor 2023, ora 16:00.

Vetëm kandidatët e sukseshëm do të kontaktohen!

AGE+ IMPLEMENTED BY:

volkshilfe.
SOLIDARITÄT



NSHC
NOVOGRADSKI HUMANITARNI CENTAR



With funding from

 Austrian
Development
Cooperation